

VENDIM
Nr.53, datë 22.12.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	anëtar i	“	“
Petrit Plloçi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Admir Thanza	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“

me sekretare Enina Mullaj, në datën 5.7.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr.26 Akti, që i përket:

KËRKUES: Taulant Mataj, përfaqësuar nga avokati Gëzim Allaraj, me akt përfaqësimi.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit të ndërmjetëm të datës 21.10.2010 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe vendimit nr.00-2010-1439, datë 25.11.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 42/2, 131/f, 134/1/g dhe 142/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Altina Xhoxhaj, shqyrtoi çështjen mbi aktet dhe diskutoi për të në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi është gjykuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal.

2. Në seancën gjyqësore të datës 21.10.2010, mbrojtësi i kërkuesit ka kërkuar para Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda shpalljen e moskompetencës lëndore të saj për gjykimin e kësaj çështjeje dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si gjykata kompetente.

3. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin e ndërmjetëm të datës 21.10.2010, ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

4. Kundër këtij vendimi të ndërmjetëm ka bërë rekurs të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë mbrojtësi i kërkuesit.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr.00-2010-1439, datë 25.11.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit.

6. Me kërkesën e datës 29.4.2011, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës.

7. **Kërkuesi** pretendon se vendimet e mësipërme të gjykatave janë të papajtueshme me Kushtetutën dhe parashtron në thelb këto shkaqe për shfuqizimin e tyre:

i) Gjykatat kanë cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Bazuar në nenin 75 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), vepra penale për të cilën është akuzuar kërkuesi

nuk është në kompetencë të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

ii) Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është i padrejtë dhe i paarsyetuar.

iii) Gjykata e Lartë nuk i referohet nenit 431 të KPP-së si bazë ligjore, por i referohet nenit 433 të KPP-së.

II

8. Gjykata vëren se, bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, individit mund t'i drejtohet kësaj Gjykate për gjykimin përfundimtar të pretendimeve të tij për cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte.

9. Gjykata ka vlerësuar se Kushtetuta duhet interpretuar në atë mënyrë që të ketë kuptimin më të arsyeshëm dhe të frytshëm të mundshëm. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ajo mund të kërkohe vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimin nr.28, datë 23.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Shterimi nënkupton që kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr.1, datë 25.1.2010 dhe nr.17, datë 16.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata vëren se, bazuar në nenin 431 të KPP-së, janë objekt rekursi të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë vendimet e gjykatave për mosmarrëveshjet lidhur me juridiksionin dhe kompetencat, si dhe rastet e veçanta të parashikuara me ligj. Bazuar në nenin 89 të KPP-së, ka mosmarrëveshje kompetencash, në çdo gjendje a shkallë të procedimit, kur dy a më shumë gjykata, në të njëjtën kohë, marrin ose nuk pranojnë të marrin për shqyrtim të njëjtën akuzë, që i atribuohet të njëjtit person. Për të pasur një mosmarrëveshje kompetencash nevojitet bashkëekzistenca e vullneteve të kundërta të dy ose më shumë gjykatave për të marrë në shqyrtim ose për të refuzuar shqyrtimin e të njëjtës çështje, çka sjell si pasojë pezullimin e procedimeve.

11. Bazuar në nenin 90 të KPP-së, mosmarrëveshja mund të parashtrahet nga prokurori pranë njërës prej gjykatave në mosmarrëveshje ose nga i pandehuri dhe palët private. Gjykata thekson se përmbajtja e kësaj dispozite kërkon ekzistencën e një konflikti real dhe efektiv dhe jo një situatë konflikti potenciale të pretenduar nga njëra nga palët në proces. Në rast të parashtrimit të mosmarrëveshjes nga palët, gjykata bën një vlerësim në lidhje me kompetencën e saj, nga e cila rrjedh ose jo konflikti, dhe në rastin e parë ngre çështjen e mosmarrëveshjes dhe merr vendim me të cilin i dërgon aktet Gjykatës së Lartë për zgjidhjen e konfliktit, kurse në rastin e dytë, pra nëse vlerëson se nuk ndodhet para një mosmarrëveshjeje kompetencash, vazhdon gjykimin e çështjes dhe në këtë rast palëve u lind e drejta t'i drejtohen Gjykatës së Lartë me rekurs të drejtpërdrejtë në kuptim të nenit 431 të KPP-së. Pra, kusht i nevojshëm paraprak për të vënë në lëvizje një rekurs të drejtpërdrejtë është roli i gjyqtarit/gjykatës.

12. Nga rrethanat e çështjes konkrete rezulton se çështja penale në ngarkim të kërkuetit Taulant Mataj është gjykuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Në seancën gjyqësore të datës 21.10.2010 mbrojtësi i kërkuetit i është drejtuar gjykatës me kërkesë për shpalljen e moskompetencës së saj lëndore për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të kërkuetit dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si gjykata kompetente. Kjo kërkesë e mbrojtësit të kërkuetit është rrëzuar nga gjykata me vendimin e ndërmjetëm të datës 21.10.2010. Në këto kushte, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me rekurs të drejtpërdrejtë për të kundërshtuar vendimin e ndërmjetëm të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr.00-2010-1439, datë 25.11.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi.

13. Bazuar në rrethanat e çështjes konkrete dhe në pretendimet e kërkuetit, Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk rezulton të ekzistojë ndonjë mosmarrëveshje kompetencash mes gjykatave, rrethanë kjo ligjore që do të legjitimonte subjektet e gjykimit të ushtronin rekurs të

drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë, në kuptim të nenit 431 të KPP-së. Gjykata thekson, megjithatë, se pretendimet e palëve në lidhje me kompetencën e gjykatës nuk i mënjanojnë kontrollit të mëtejshëm gjyqësor, pasi një pretendim i tillë mund të paraqitet lirisht jo vetëm para gjykatës që shqyrton çështjen, por mund të parashtrohet më tej në gjykatat më të larta si shkak për apel apo për rekurs.

Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkesi nuk ka shteruar mjetet ligjore për t'iu drejtuar kësaj Gjykate në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Altina Xhoxhaj.

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Admir Thanza.